



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati i Universitetit

Pejë, __.7.2026

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mbështetur në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenet 47 dhe 48 të Statutit Nr. 04-V-622, datë 30.5.2013, në mbledhjen e mbajtur me datë 20.7.2026, mori këtë:

V E N D I M


Për kushtet dhe vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit të studimeve bachelor dhe master, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve

- I. Lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve deri më 30.9.2027, për studentët e nivelit të studimeve bachelor, si në vijim:
 - I.1. Studentët e nivelit bachelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2018/2019, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, por kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e dy (2) viteve paraprake;
 - I.2. Studentët e nivelit bachelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2018/2019, dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet që përfundojnë me mbrojtje të punimit të temës së diplomës, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit;
 - I.3. Studentët e nivelit bachelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2016/2017, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e tri (3) viteve paraprake;
 - I.4. Studentët e nivelit bachelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2016/2017 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet ku studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, ndërsa në programet ku studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy (2) provime të vitit të fundit.
- II. Lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve deri më 30.9.2027, për studentët e nivelit të studimeve master, si në vijim:

- II.1. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2022/2023, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe kanë dhënë 50% të provimeve të parapara, si dhe kanë regjistruar vitin akademik 2025/2026;
- II.2. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2022/2023, të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet dhe kanë vetëm mbrojtjen e temës së diplomës;
- II.3. Studentët e nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2020/2021, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe nëse kanë përfunduar provimet e vitit të parë, si dhe kanë regjistruar vitin akademik 2025/2026;
- II.4. Studentëve të nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2020/2021 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet dhe kanë vetëm mbrojtjen e temës së diplomës.
- III. Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve bachelor dhe master të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta për vit studimi, ndërsa aktualisht janë në vitin e parë (I), të dytë (II), të tretë (III) apo të katërt (IV), të cilët përbëjnë përjashtim nga pikat I dhe II të këtij vendimi, u mundësohet vazhdimi i studimeve në programet e reja (të akredituara) të studimit.
- IV. Ndërrimi i programit të studimit si në pikën III është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit dhe vetëm një herë përgjatë periudhës së studimeve.
- V. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të dispozitave përkatëse të Statutit, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
- VI. Studentëve të nivelit bachelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e parapara në programet në të cilat studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2027. Vlerësimi i suksesit akademik të kandidatëve në provime do të bëhet nga profesorë ose komisione të autorizuara nga dekani i njësisë akademike përkatëse.
- VII. Ndërlidhur me çështjet e trajtuara dhe përcaktimet e këtij vendimi, obligohen njësitet akademike të bëjnë analizë empirike, respektivisht studim të përgjithshëm lidhur me problemet konkrete, me qëllim të identifikimit të zgjidhjeve, respektivisht propozimit të ndërmarrjes së masave specifike, për adresim në Senatin e UHZ-së, deri më 31.5.2027.
- VIII. Obligohen Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë dhe njësitet akademike të tij ta publikojnë vendimin në ueb faqet e tyre zyrtare dhe që përmes mënyrave më të përshtatshme të njoftimit, së paku dy herë gjatë vitit akademik 2026/27, respektivisht një njoftimi për semestër, t’i informojnë studentët lidhur me përmbajtjen dhe përcaktimet e këtij vendimi.

- IX. Obligohen njësitë akademike që të gjitha procedurat në zbatim të këtij vendimi t'i përfundojnë jo më vonë se deri më 30.9.2026, përfshirë pajisjen e studentëve me vendimet përkatëse, me qëllimin të fillimit të rregullt të vitit akademik 2026/2027.
- X. Ky vendim vlen vetëm për vitin akademik 2026/2027.
- XI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen aktet tjera që rregullojnë çështjet e trajtuara me këtë vendim.
- XII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e UHZ-së.

Senati i UHZ-së:


Prof. dr. Armand Krasniqi, kryesues



T'u dërgohet:

- Anëtarëve të Senatit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dekanëve të njësive akademike;
- Sekretarëve të njësive akademike;
- Zyrës për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie;
- Zyrës për Çështje të Studentëve;
- Zyrës për Teknologji të Informacionit;
- Zyrës për Protokoll dhe Arkiv.